



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 20

Datë: 31. 05. 2019. Ora: 11:30

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ.

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Florian Dushi, Adnan Rrustemi, Nazlije Bala, Ercan Spat, Alfred Kinolli, Cemajl Kurtish.

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ, Valmira Selmani, u.d. (ZRPP).

Përkthyes: Vera Dula. **Procesmbajtës:** Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

2. Raport i Këshillave të KQZ-së

a. Këshilli për Buxhet dhe Financa

-Shqyrtimi i Raportit tremujor financiar i buxhetit të KQZ-së

-Shqyrtimi dhe miratimi i Raporti vjetor për Sistemin e Kontrollit të Brendshëm në KQZ

3. Të ndryshme

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Valdete Daka: Përshëndetje. E keni rendin e ditës. Kam një shtesë, sado që kjo nuk ka kaluar në Këshillin për Marrëdhënie me Jashtë. Përfaqësuesi i OSBE-së, mu lut që ynë ta procedoj drejtpërdrejt në KQZ një kërkesë të tyre për shkak të procedurave që ata kanë. OSBE, planifikon që të mbështesë pjesëmarrjen e tre anëtarëve të OSBE-së në ACEO...

Ercan Spat: Në bisedat tona, u përmend që këshilli nuk është takuar. Por, KQZ është organ më i lartë...Pastaj, edhe informacionet kanë ardhur ende pa u konstituuar KQZ...

Valdete Daka: Kush është për këtë rend dite, me propozimin tim...?

Anëtarët e KQZ-së miratuan rendin e ditës.

2.Raport i Këshillave të KQZ-së

b. Këshilli për Buxhet dhe Financa

1. Shqyrtimi i Raportit tremujor financiar i buxhetit të KQZ-së:

Nazlije Bala: Këshilli, është takuar në mbledhjen e dytë. Janë shqyrtuar dy pika. E para, raporti tremujor financiar i buxhetit të KQZ-së. Mbi këtë raport, kemi diskutuar sa u përket shpenzimeve për katër kategori financiare. Kemi rekomanduar specifikimin e shpenzimeve. Ky është një informacion lidhur me shpenzimet tremujore janar – mars 2019.

Valdete Daka: Kjo është informatë nga këshilli, dhe nuk ka nevojë të votohet...!

Sami Hamiti: Mendoj që duhet të votohet, kurse në takim kam pasur disa vërejtje. Mendoj që në këshill, duhet të vendosim një standard tjetër të raportimit në bazë të kërkesave të ligjit. Ne, anëtarët e KQZ-së ta shohim gjendjen si është, ti shohim projektet, investimet kapitale, llogaritë e arkëtueshme... Anëtarët e KQZ-së duan ta dinë si e kemi situatën me investime por edhe me procedurat gjyqësore me operatorët...Gjobat që janë, a janë pagua, qysh janë pagua...! Operatorët, në cilin nivel janë dhe në fund, është një deklaratë që edhe KE të deklarohet në bazë të mjeteve që ka a mundet t'i kryej obligimet që ka...

Adnan Rrustemi: Po gjykoj lidhur me idenë e buxhetit në përgjithësi dhe me dinamikën e planit të punës për këtë vit...Tani jemi edhe në fazën e rishikimit të buxhetit për pjesën e dytë të vitit. E kemi një plan të punës së këtij viti i cili, nuk është se ka kaluar në KQZ në mënyrë të rregullt as në hartim dhe as në KQZ për shkak të situatës së KQZ-së...Ranë zgjedhjet, dhe ne nuk kemi mundur ta trajtojmë qysh duhet...Por, tani duhet të ulemi dhe ta shqyrtojmë së bashku dhe ta trajtojmë me përkushtim, me të gjitha kapacitetit e nevojshme...

Valdete Daka: Kush është për aprovimin e këtij raporti të KB-së ?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan raportin tremujor financiar të buxhetit të KQZ-së:

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raporti vjetor për Sistemin e Kontrollit të Brendshëm në KQZ

Nazlije Bala: Ne, e kemi shqyrtuar edhe raportin vjetor për Sistemin e Kontrollit të Brendshëm në KQZ –së të vitit 2018. Ky sistem apo vlerësimi i tij, bëhet për herë të parë në KQZ-së. Është ndërtuar mbi katër linja kryesore:

- *Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së kontrollit të brendshëm në KQZ*
- *Gjetjet kryesore dhe gjendja aktuale në fushën e monitorimit*
- *Dokumentet strategjike të KQZ-së*
- *Plani i veprimit për adresimin e dobësive të identifikuara dhe rekomandimeve të auditorëve.*

Këtij raporti, i është bashkangjitur edhe “Deklarata” e kontrollit të brendshëm zyrtar të atyre që janë përgjegjës për hartimin, përpilimin dhe nënshkrimin e këtij dokumenti. Si dhe, pyetësi vet vlerësues...

Me anëtarët e këshillit, kemi diskutuar dhe rekomanduar që ky raport, të rregullohet teknikisht dhe përmbajtësisht sepse ka diskrepancë me dokumentet e tjera. Në bazë të vlerësimit tonë, ne e rekomandojmë në KQZ të miratohet. Uroj që ky raport, të zbatohet sipas kornizës dhe objektivit të tij...

Sami Hamiti: Po, është diskutuar goxha gjatë. Format i parë, nuk kishte plotësuar kriteret të vij në KQZ, por duket që janë bërë mjaft korrigjime. Por, te sistemi i kontrollit të brendshëm, ky është dokument i Sekretariatit. Unë besoj që, kur të na vijnë raportet e auditorit gjeneral dhe atij të brendshëm, dyshoj që nuk do të jenë të njëjta...Mendoj që e keni mbivlerësuar veten... Uroj të mos jetë kështu, por dyshoj që ky dokument do të jetë i përafërt me raportet që përmenda... Jam për votim të këtij dokumente...

Florian Dushi: e mirëpres këtë formë të punës, që siç u tha bëhet për herë të parë në KQZ dhe Sekretariat...Pres që, të mos kenë qenë edhe aq subjektiv, sa të jenë të paraqitura të gjitha dobësitë eventuale të institucionit tonë...Por, janë edhe organet e tjera institucionale që, në vitet vijuese të korrigjohemi, t’i korrektojmë proceset...Do të shohim se cilat janë mjetet, dhe ne të jemi sa më objektiv në paraqitjen e raporteve të kontrollit të brendshëm dhe, kjo do të ndihmojë në secilin segment...Meqë është hera e parë, si dokument gjykoj që në këtë fazë të korrigjohet objektivisht...

Adnan Rrustemi: Diskutimi dhe dokumenti, po e determinon faktin që të aktivizohet Komiteti për Auditim. E dyta, janë disa gjetjet të mia që duhet të jenë më të matshme, më konkrete...! Ne, duhet të përpiqemi që auditimi i brendshëm, madje të jetë edhe më rigoroz se auditimi i jashtëm, gjithmonë me idenë që aktivitetet të përcillen për së afërmi dhe me qëllim të funksionalizimit të institucionit...Aktivizimi i komitetit të auditimit të brendshëm, e rritë gamen e mbikëqyrjes...

Anëtarët e KQZ-së, aprovuan raportin vjetor të Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në KQZ

3.Njoftimi nga OSBE

Valdete Daka: Mbledhja e ACEEO-së, është në patronatin e KQZ të Sllovenisë, dhe do të mbahet nga data: 24 – 26 shtator 2019. Misioni i OSBE-së, do të mbuloj shpenzimet e tre përfaqësuesve të KQZ, një nga organizata civile, dhe një nga OSBE. Ne, duhet ti dërgojmë tre emra – anëtar të KQZ-së, si pjesëmarrës në këtë konferencë.

Sami Hamiti: Konsideroj që, KQZ të shtoj edhe një anëtarë: nga tre, në katër. Shpenzimet të mbulohen nga KQZ, nga buxheti për udhëtime jashtë, pra nga buxheti i KQZ-së. Propozoj kryetaren, Florian Dushin, një nga VV dhe, një nga komunitetet. Të jetë përfaqësimi sa më i denjë...

Adnan Rrustemi: Duhet ta trajtojmë çështjen si të ndarë. Ne, edhe jemi anëtar i ACEEO-së. Mendoj që duhet ta diskutojmë së pari përmbajtjen e pjesëmarrjes, e pastaj përfaqësimin... Falenderoj OSBE-në, dhe jam për ta rritur pjesëmarrjen. Të jetë edhe dikush nga Sekretariati. Por, nuk e di as temën...

Valdete Daka: Po, tema është kjo: “Mbrojtja juridike e të drejtave zgjedhore, dhe transparenca në zgjedhje”. Tani, kemi edhe propozime për rritjen e numrit...

Pra, kemi edhe propozime: Kryetarja, Floriani, Nazlija, Ercani dhe, propozoj që Xhemajl Pecani si përfaqësues ligjor të shkoj nga Sekretariati. Të jemi të qartë: tre nëtar paguhen nga OSBE, dhe dy nga KQZ...

Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan pjesëmarrjen në Slloveni.

Të ndryshme.